



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Kom.Dh.Shk.II.nr.857/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Saranda Bogaj-Sheremeti, kryetare e kolegjit, Franciska Zhitija -Ymeri dhe Faton Barjami, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit “E...” sh.p.k., me nr. Të biznesit me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Ardita Morina, avokate nga Prishtina, kundër të paditurës N.P.T “P....”, me nr. Biznesi, me seli në fshatin, Komuna e Kamenicës, me pronar A.D, për shkak të mos përmbushjes së kontratës, në shumë të përgjithshme prej 27,581.40€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.573/2019, të datës 23.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.11.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit “E...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.573/2019, të datës 23.11.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar EK.nr.573/2019, të datës 23.11.2021, në piken I të dispozitivit të aktgjykimit e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses “E....” sh.p.k. me numër të biznesit, me seli në Prishtinë, Lagjja, Rruga “....” Nr....., ku është detyruar e paditura N.P.T “P....”, m numër të biznesit, me pronarë A.D, me adresë në fshatin, Komuna e Kamenicës që paditëses në emër të avansit t’ia kthej mjetet në shumën prej 27,581.40€, me kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke filluar nga data 07.10.2019 dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën prej 924,00€ të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes pranimit të këtij aktgjykimin nën kërcënimin e përmbarimit. Ndërsa në piken II të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses “E....” sh.p.k. me numër të biznesit, me seli në Prishtinë, Lagjja,

Rruga “...” Nr. në shumën prej 5,418.60€ në emër të kthimit të avancit dhe në emër të fitimit të humbur, në shumën prej 27,231.93€, për periudhën kohore nga data 23.06.2017 e deri me datën 27.09.2021 me të cilën kishte kërkuar paditësja që edhe për këto kërkesa të detyrohet e paditura N.P.T “P...”, m numër të biznesit, me pronarë A.D me adresë në fshatin, Komuna e Kamenicës që ta kompensoj.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar duke e prishur aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ose të ndryshoje aktgjykimin e shkallës së parë, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës , aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, “E...” sh.p.k., me seli në Prishtinë, me datën 07.10.2019 ka paraqitur padi kundër të paditurës N.P.T “P...” me seli në fshatin, Komuna e Kamenicës, me pronar A.D, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet që paditësi në emër të avansit t’ia kthej mjetet në shumën prej 33,000.00€, dhe në emër të fitimit të humbur në shumën prej 27,231.93€ për periudhën kohore nga data 23.06.2017 e deri me datën 27.09.2021 me kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke filluar llogaritja e kamatës nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në gjykatë e deri në pagesën definitive, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës në shumën prej 2,139.00€, të gjitha këto si shkak se e paditura nuk ju ka përmbajtur deklaratës nën betim me shenjen LRP.r.292/2018 e datës 16.02.2018 e dhënë para noterit Kolë Ramaj, në Komunën e Graçanicës, me propozimin për gjykatën që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar ngase paditësja me kërkesën e saj ka kërkuar që dëmi material në emër të avansit të kthehet në shumën prej 33,000.00€, ku gjykata e shkallës së parë bazuar në ekspertizën financiare ka gjetur se e paditura ia ka dërguar mallin paditëses në sasi prej 24,84 ton pelet që kap shumën prej 4,098.60€ dhe një here tjetër në sasia prej 8 ton pelet në vlerë prej 1,320.00€ ku nga kjo vjen në përfundim se e paditura mbetet në detyrim ndaj paditëses në shumën prej 27,581.40€, ku edhe ka vendosur që në emër të demit material- avansit ta aprovoje kërkesëpadinë në shumën prej 27,581.40€, ndërsa për shumën prej 5,418.60€ ta refuzojë si të pabazuar ashtu siç është vendosur në piken II të dispozitivit të aktgjykimit sepse për këtë pjesë të shumës së refuzuar paditësja është furnizuar me mallin pelet. Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me rastin e vendosjes sa i përket pjesës refuzuese të kërkesës për fitimin e humbur e ka shqyrtuar edhe raportin e ekspertizës financiarë dhe ka ardhur në përfundim se konstatimet e ekspertës financiare nuk janë në përputhje me provat e lëndës, ku nga ekspertiza është konstatuar së vlera e shitjes sipas viteve

2017,2018,2019, mirëpo nuk ka marrë për bazë faktin se pala paditëse nuk ka prezantuar prova se sa ka bërë shitje të paraqitura në ATK, përkatësisht në shkresat e lëndës nuk ka asnjë kontratë të prezantuar nga paditësja , e me të cilën do të vërtetohet se si shkak i mos furnizimit me pelet nga e paditura nuk ka mundur paditësja ti realizon kontratat e saja në mënyrë që të fitojë të drejtën eventuale për kompensimin e kërkesës dhe mbi këtë bazë konstatimit të ekspertës në lidhje me dëmin eventual që ka mundur ti shkaktohet palës paditëse nuk është marrë për bazë pasi që sipas bindjes së gjykatës së shkallës së parë një konstatim i tillë është i mbështetur në deklaratimet pretendimet e palës paditëse, e jo në prova dhe se i njëjti nuk korrespondon me gjendjen reale faktike të vërtetuar gjatë shqyrtimi gjyqësor.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së më këtë rast lidhur me bazën e kërkesëpadisë ia ka falur besimin deklaratës nën betim me shenjën LRP.nr.292/2018 të datës 16.02.2018 e lidhur para noterit Kolë Berisha në Komunën e Graçanicës, në të është konstatuar nga vetë pronari i të paditurës që ka detyrim ndaj palës paditëse, dhe më këtë rast gjykata nuk është lëshuar edhe me teje në vlerësimin e bazueshmërisë së kërkesës, meqenëse deklaratata është dhënë para noterit e që është dokument publik. Prandaj, gjykata e shkallës pare ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit në pjesën e kërkesës për fitimin e humbur është e pa bazuar, dhe mbi këtë bazë dhe duke u mbështetur në dispozitat e nenit 245 par.1,137, 173 të LMD-së, si dhe në dispozitën e nenit 134 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të atakuar.

Gjykata Komerciale- dhomat e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale përkatësisht dispozitën e nenit 245 par.1 të LMD-së ku përcaktohet se “ *kreditori në marrëdhëniet e detyrimeve ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjëgjje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”. Në rastin konkret rezulton së paditësja me kërkesën e saj ka kërkuar dëmin material në emër të avansit në shumën prej 33,000.00€, mirëpo bazuar në ekspertizën financiare e datës 27.09.2021 e punuar nga ekspertja financiare znj.V.V rezulton se të paditurës ia ka dhënë avans 33,000.00€, mirëpo me pranimin e mallit prej 24,84 ton pelet që kap shumën prej 4,098.60€ dhe pas pranimit tjetër të mallit prej 8 ton pelet në vlerën prej 1,320.00€ vërtetohet se e paditura mbetet në detyrim ndaj palës paditëse në shumën prej 27,581.40€.

Po ashtu, Gjykata Komerciale- dhomat e shkallës së dytë vlerëson së gjykata e shkallës së parë drejte ka vepruar kur e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me fitimin e humbur, ku nga raporti i ekspertizës financiare rezulton se konstatimet e ekspertizës nuk janë në përputhje me provat nga shkresat e lëndës , ekspertja në raportin e saj të ekspertizës ka konstatuar vlerën e shitjes sipas

viteve 2017,2018, dhe 2019, mirëpo nuk ka marrë për bazë faktin se pala paditëse nuk ka prezantuar prova se sa ka bërë shitje të paraqitura pranë ATK-së, po ashtu nga shkresat e lëndës nuk ka asnjë kontratë të prezantuar nga paditësja me të cilën do të vërtetohej se si shkak i mos furnizimit me pelet nga e paditura nuk ka mundur paditësja ti realizon kontratat e saja në mënyre që të fitojë të drejtën eventuale për kompensimin e kërkesës edhe për fitimin e humbur. Prandaj kjo gjykatë vlerëson se pala paditëse nuk ka mundur që më prova konkret ta vërtetojë faktin së gjate kësaj kohe ka pasur fitim të humbur, dhe se pretendimet e palës së paditur nuk korrespondojnë me gjendjen reale faktike të vërtetuar, dhe rrjedhimisht duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar rezulton se kërkesëpadia e paditësit në pjesën e kërkesës për fitimin e humbur është e pabazuar.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe dispozitën e nenit 173 dhe 174 të LMD-së, kur e ke refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me fitimin e humbur, të cilat dispozita t parashohin se: *“i dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar dhe se dëmi duhet të kompensohet në mënyrë të plotë ashtu që gjendja materiale e dëmtuesit të sjellët atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues”*, andaj bazuar në këto dispozita, kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar sepse paditësit nuk ka mundur që më prova konkrete ta vërtetojë faktin së gjate kësaj periudhe ka pasur fitim të humbur dhe më të drejte gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar këtë pikë të kërkesëpadisë.

Gjykata Komerciale, dhomat e shkallës së dytë gjeti se në bazë të marrëveshjes paraprake për bashkëpunim tregtar në mes dy bizneseve lidhur me pagesën në avans kaparin e mjeteve monetare në shumën prej 33,000.00€ këto mjeteve rezulton së janë transferuar në formë avansi para marrjes së mallit kjo edhe vërtetohet edhe nga transferet e kryera përmes bankës nga transferet e kryera. Andaj, kjo gjykatë vlerëson se ekziston obligimi i të paditurës që paditësit në emër të kthimit të mjeteve të paguara në formë të avansit t’ia paguaj shumën prej 27,581.40€. Prandaj, kjo gjykatë vlerëson së ekziston borxhi i palës së paditur ndaj palës paditëse në shumën e përgjithshme prej 27,581.40€ për arsye së i padituri nuk e ka përmbushur detyrimin e tij kontraktues sipas marrëveshjeve të lidhur ne mes palëve për dorëzimin e mallit-peletin.

E paditura, duke mos e kryer detyrimin e saj, rezulton se i ka mbetur borxh paditësit për pagesën e kryer në forme të avansit (kaparit), andaj ndërmjet palëve ndërgjyqës është krijuar raporti detyrimor, në të cilin paditësi e ka cilësinë e kreditorit ndërsa e paditura cilësinë e debitorit. Sipas Nenit 262 të Ligjit mbi marrëdhëniet e detyrimeve *“kreditori në marrëdhëniet detyimore ka të drejtë që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, si dhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për shkak të mos-përmbushjes së detyrimit apo vonesës në përmbushje, ndërsa debitori ka për detyrë përmbushjen e detyrimit në tërësi”*, prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se pala e paditur i ka kryer punët vetëm pjesërisht punët e kontraktuara për dorëzimin e mallit- peletin, ku dorëzimin e mallit e ka bërë vetëm për shumën n prej 5,418.00€, ndërsa pala paditëse i ka bërë pagesën në emër te avansit kaparit shumën prej 33,000.00€, ku nga kjo rezulton se pala e paditur i ka mbetur borxh palës paditëse në shumën prej 27,581.40€.

Gjykata Komerciale i vlerësoi pretendimet ankimore të palës paditëse në lidhje me atë së paditësi ka pësuar humbje në forme të fitimit të humbur, mirëpo këto pretendime i vlerësoi si të

pabazuara sepse nga provat dhe shkresat e lëndës rezulton se pala paditëse nuk ka prezantuar prova se sa ka bërë shitje të paraqitura pranë ATK-së, si dhe nga shkresat e lëndës nuk është vërtetuar se nuk ka asnjë kontratë të prezantuar nga paditësja me të cilën do të vërtetohet se si shkak i mos furnizimit me pelet nga e paditura nuk ka mundur paditësja ti realizon kontrata e saja.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të palës paditëse lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë, e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale- dhomat e shkallës së dytë. .

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhomat e shkallës së dytë,

Kom.Dh.Shk.II.nr.857/2022, dt. 10.11.2022

**KRYETARE E KOLEGJIT,
Saranda Bogaj -Sheremeti, d.v.**